MENDIMI FILOZOFIK NË VEPRËN E PIKTORIT TË SHQUAR GAZMEND LEKA

“MAGJIA E VIZATIMIT”

E GAZMEND LEKËS

Mal Berisha

Të marrësh pjesë në hapjen e ekspozitave të piktorit tonë të mrekullueshëm, Gazmend Leka, nuk është thjesht një orë e kaluar në mënyrën më të kulturuar të mundshme. Është një orë ku takon eminencat e artit figurativ shqiptar. Është një akt iluminimi, edukimi estetik, përsiatjeje dhe ndjesie të bukur artistike, por edhe hedonistike.

Në krye të të gjithë këtyre elementëve njohës dhe përfytyrues të artit të tij të jashtëzakonshëm figurativ, qëndron një element tjetër që i tejkalon të gjithë:

Mendimi filozofik që e përshkon veprën e tij — në fakt, magjinë e tij artistike.

Duke qenë shumë mirënjohës për ftesën ekskluzive që më dërgoi për pjesëmarrjen në ekspozitën e tij të radhës, me titull *“Magjia e Vizatimit”*, pata rastin të takohesha me shumë artistë të shquar të artit tonë figurativ, si Prof. Naxhi Bakalli, Kreshnik Xhiku, Vasil Raka, Najada Hamzai e shumë të tjerë.

Do të dëshiroja të dija ta përshkruaja vetë magjinë e artit të Gazmend Lekës, por ja që ai na e lehtësoi këtë punë me përshkrimin e vet që e kishte vendosur në hyrje të ekspozitës:

Faleminderit shumë, Mjeshtër!

MAGJIA E VIZATIMIT

U gjenda në Louvre pikërisht dyshe kur e kisha eksponitë me vizatimet e Leonardo da Vinci-t. Nëpër muret e ndriçuara me kujdes ishin eksponuar disa vizatime të vogla, punuar në sepia e sanguinia. Kanë kaluar shumë vite që atëherë, por gjithçka më është ngulitur në kujtesë si një përjetim i freskët.
Dritat në sallë ishin të ulëta, thuajse muzgim. Vizitorë lëviznin me një heshtje përulëse, si pelegrinë në një vend të shenjtë. Në atë atmosferë të ngarkuar me admirim, papërtur më dukën përpara dy kryevepra të Leonardo-s, njëri vizatim dhe tjetra pikturë – Virgjëresha me djalin dhe Shën Ana me Shën Gjon Pagëtorin. I kishin vendosur pranë, ndoshta si një lloj pedagogjie muzeale, për të treguar ndërmjet nga skica në realizimin përfundimtar, edhe pse nuk ishin identike. Ishte një mënyrë për të edukuar vizitorin, për t'i shpjeguar procesin krijues.

Mua nuk më pëlqen.
M'u duk sikur pikturа i merrte shtrin tjetrës, ose e dobyrosite të justifikohej si paramendëse. Megjithatë, para vizatimit ngriva. Nuk lëvizja. Vështrova me kujdes çdo vijë, çdo prekje të lehtë, çdo shumatirë. Hallkja që ty te pikturа në krah dhe kthehesha sërish te vizatimi, sikur dicka më tërhiqte më me forcë. Më magjepsi. M'u duk sepia më e bukur në botë.
Në ayet e gjithkuqë pikturа është ajo që ndjetet, ajo që njerëzërisht më së shumti në albume, kartolina e në kalendarë. Pse për mua atë çast pikturа nuri vendin e vet. U bë "e bukur", por e largët, përballë asaj që po mrekullonte më "thelbi" vizatimi. Prekja e sepias dhe karbonçinës fitnin më shumë se çdo ngjyrë, se çdo shumaturë. Ishte si të shihje shpirtin përpara se të vishej me trup.

Pikturа, me gjithë përkryerjen e saj, m'u duk si përmbyrje. Nuk po e shihja si "hesje mënjanë", përkundrazi. Vizatimi më krah m'u shfaq si një thirrje e fshehtë, një përkpëritmë që vinte nga thellësia. E panjafruar, e papërfunduar, por e paktrahasueshme në fryrjet. Isha shjeshë i paralizuar nga fuqia e tij, tërheshur nga çdo iluzion, çdo shkëlqim e çdo shtresë. Ndoshta ky vizatim edhe në kohën kur u krijua ndryshoi syrin e shikuesit, mentalitetin e tij, që të mos shihej më si shërbëtor serveil i pikturës. Ary, atë çast, pikturа m'u duk si gjuha e trupit dhe vizatimi si gjuha e shpirtit. Në fund të fundit, vetë Leonardo shkruante se: "Vizatimi është rruga më e shqertë për të lexuar tiparëzën e dikujt."

Gjithçka nis me një vizë. Jo vetëm te vepra, por edhe te vetë njeriu. Që në fëmijëri, vizatimi shfaqet si një mjet i parë i të shprehurit. Fëmijët shkarravisin e vizatojnë duke projektuar botën e tyre të brendshme përmes figurave të thjeshta, por shpesh domethënëse. Kjo nuk është rastësi. Vizatimi është një akt i paetër, i çliruar nga gjykimi, një mënyrë për të komunikuar me ndjenjat përtej fjalës së arsyes. Si fëmijë, mësova të vizatoja para se të flisja. Para se të shkruaja, bëja vija, rrathë, spirale, dëshira fokusova objektet. Ato vizatime i nxierja jashtë pa filtra, pa dekor, pa bukuri të shtruar. Ishin gremat e para të të shprehurit.

Artisti vetë, kur vizaton, duket si anatomisti i të padukshmes. Vijat që ai i lë si gjurmë në letër, janë gjurmë jete, janë tralyet e pulsit të tij, si edhe pikturа. I tillë, vizatimi nuk është vetëm akt përgatitor. Është magji në vete. Është gjuha e asaj që ende nuk ka ndodhur. Nuk i bindet ngjyrës, nuk i shërben dekorit.

I shërben thelbit.
Më ndodh shpesh të mendoj se pikturа i ngjan jetës së jashtme, ndërsa vizatimi jetës së brendshme. Pikturа të kërkon të jesh i plotë, vizatimi të lejon të jesh i thyer. Ary ku ngjyra flet për dritën, vija flet për hijen, që ngrihet nga mendja.
Në shajet e një vizatimi, lëvizi dora e Arkitektit të Madh, ku në qendër është njeriu lakuriq dhe i pambuluar, i sinqertë dhe i qadishëm. Më këtë gjuhë, ne zmuajt të bertasim pa zë, të tregojmë dashuri pa objekt, të ershëjmë endrra pa ngjyrë. Shpesh e vërtetë nuk ishte sfondi i ersët i pikturës, por është vizatimi, ary ku baconi e puthëtra, e padukshmja, ajo që nuk është ngjinur ende, por ndihet si prani.

Pikturа të josh fort, vizatimi të fton brenda. Pikturа të kënaq syrin, vizatimi të ndriçon shpirtin. Pikturа është rezultat, vizatimi është udhëtim dhe ndoshta për këtë arsye përpara asaj pikture të mrekullueshme, të përkryer, ndjeva një boshllëk, ndërsa përballë vizatimit ndjeva mercën e boshllëkut.
Në një botë ku fjala është bërë e lehtë, e shpejtë dhe shpesh boshe, vizatimi mbetet një nga mënyrat më të thella e më të ndershme të komunikimit. Ai është më shumë sesa një art, është një magji e brendshme, që merr jetë përmes dorës së njeriut dhe shpërhet në letër si një fryrmë që nuk mund të ndalet. Magjia e tij qëndron në faktin se nuk ka nevojë për përkthim. Një vizatim, si edhe pikturа, kuptohet njësoj si nga një fëmijë ashtu edhe nga një i moshuar dhe ary ku nuk arrijnë dot fjalët, flikojnë vijat.

Magjia e vërtetë e vizatimit është se ai nuk kopjon realitetin, por e rikrijon atë në mënyrën më intime dhe personale. Objekti nuk është më objekt, por mënyra si ndihet thelbi i tij, pa të tepërta. Kjo e bën vizatimin një akt të thellë emocional, por edhe filozofik.
Vizatimi, gjithashtu, është një mjet i fuqishëm për të përballuar vetën. Në kohë trazimi, ankthi apo dhembjeje, të shumë janë ata që ngjallin të vizatojnë, qofë edhe në tryezën e një kafeneje çfardo. Nuk pikturojnë, por vizatojnë. Jo për të tregtuar dicka të bukur, por për të çliruar atë që i ndodh brenda. Ai bëhet një lloj terapisti i heshtur, një pasqyrë që të ndihmon të shohësh me qartë vetveten. Në kaosin e vijave të hedhura katara fshihet vetë shkarravitësi që po vizaton. Është art-terapi. Është dëshmia se brenda njerëzit fshihet dicka më shumë sesa kogjika, një bucim ndjenje, endrre dhe krijimtarie. Përmes tij, arrijmë të prekim të padukshmen, të shprehim të pathënën, të kuptojmë veten dhe botën. Dhe në një kohë kur gjithçka matet me shpejtësi dhe produktivitet, vizatimi na mëson të ndalemi, të shikojmë më thellë dhe të dëgjojmë atë që nuk flitet.
Për këtë arsye, ndoshta, vepra më e madhe e Da Vinci-t nuk është Mona Lisa.

RIKTHIMI

Këto vërtetja në mendje atë ditë në Louvre, përballë Leonardo-s. Ishte thjeshtë ndjesi. I shkruaj këto radhë, arpar po cilësi veten shpërmajet vizatimit. Nuk është një proces i thjeshtë krijimi, por një ndërtim i brendshëm, një kthim në vendet e brakitsura të kujtesës, ku gjërat e pathëna kanë mbetur pezull në një për shumë kohë. Në çdo vijë, në çdo nuancë që vizatoj, ndiej sikur po i jap formë një gjese të vetes, që më parë nuk kam dëtur ta emërtoj. Shumë nga imazhet e mia përshkohen si infino. Janë figura, forma, dridhje, shenatura, që vijnë sërish dhe sërish, si për të më thënë dicka që nuk arrita ta dëgjoj herën e parë. E kuptoj se këto nuk janë përshkrime zanafiore. Janë kujtime të mbytëra dikur, ndoshta ja vendije, si fara të hedhura në një kohë të largët, që tani kanë filluar të rritjnë. Krihohem tek ato imazhe jo për t'i kopjuar, por për t'i rilikuar. për t'i ndikuar me ayet që kam sot, ay të ngaskuar me kohë, përvojë dhe ndoshta edhe plagë.

Pse ndodh kjo? Pse më shtyn vetja të kthehem pas?
Nuk është thjeshtë nostalgji. Është dicka më e thellë, një lloj arkeologjie e brendshme, ku bëhem kërkues i brekrat në tokën e vetvetes. Gërmoj në shtresat ku kanë varosur pjesë të personalitetve të qenies sime, pjesë që ndiheet nuk kishin as fuqinë dhe as dëshirën për t'i parë. Tani, me kohën që kam kaluar dhe me veten që kam ndryshuar, u rikthehem dhe ajo që shumë nuk është e njëjta gjë. Ishte kur ishte, s'është më. Edhe kur duket e njëlloj, flet ndryshe.

Në këtë mënyrë, përsëritja në art nuk është kthim mbrapa. Është rikrijim, rikonfigurim. Si një dialog që fillon atje ku kishte mbetur pezull, por me fjalë të reja. Është si një përpjekje për të kuptuar më mirë rrënjët që më kanë formuar. Të rilindi një imazh është si të rilindi një pjesë të veres, një akt i kujtesës dhe i ndërshkrr për ta kuptuar më thellë të kaluarën. Kjo lloj pune me veten nuk është as e lehtë, as e shpejtë, por është e domosdoshme. Mbase kjo është mënyra më e sinqertë për të cuar e lazdhur cuins mbi kur rikthen në duar ato copëza që të kanë ndërruar, t'i shohësh me sy të rinj dhe t'u japësh një jetë tjetër. Në këtë mënyrë, përpara se të ndash përpara, pranon se truga drejt veres kalon përbërt nga e kaluara.

Mbjellim nga e njëjta fushë.

GAZMEND LEKA

MAGJIA E VIZATIMIT

U gjenda në Louvre pikërisht ditën kur u hap ekspozita me vizatimet e Leonardo da Vinci-t. Nëpër muret e ndriçuara me kujdes ishin ekspozuar disa vizatime të vogla, punuar në sepia e sanguina. Kanë kaluar shumë vite që atëherë, por gjithçka më është ngulitur në kujtesë si një përjetim i freskët. Dritat në sallë ishin të ulëta, thuajse mistike. Vizitorët lëviznin me një heshtje

përulëse, si pelegrinë në një vend të shenjtë. Në atë atmosferë të ngarkuar me solemnitet, papritur më dolën përpara dy kryeveprat e Leonardo-s, njëri vizatim dhe tjetra pikturë – Virgjëresha me djalin dhe Shën Ana me Shën Gjon Pagëzorin. I kishin vendosur pranë, ndoshta si një lloj pedagogjie muzeale, për të treguar kalimin nga skica në realizimin përfundimtar, edhe pse nuk ishin identike. Ishte një mënyrë për të edukuar vizitorin, për t'i zbuluar procesin krijues.

Mua nuk më pëlqeu.

M’u duk sikur piktura i merrte zërin tjetrës, ose e detyronte të justifikohej si pararendëse. Megjithatë, para vizatimit ngriva. Nuk lëvizja. Vështroja me kujdes çdo vijë, çdo prekje të lehtë, çdo sfumaturë. Hidhja një sy te piktura në krah dhe kthehesha sërish te vizatimi, sikur diçka më tërhiqte më me forcë. Më magjepsi. M’u duk vepra më e bukur në botë.

Në sytë e gjithkujt piktura është ajo që mbetet, ajo që riprodhohet më së shumti në albume, kartolina e në kalendarë. Por për mua atë çast piktura zuri vendin e vet. U bë “e bukur”, por e largët, përballë asaj që po rrezatonte më “thellë” vizatimi. Prekja e sepias dhe karbonçinës flisnin më shumë se çdo ngjyrë, se çdo sfumaturë. Ishte si të shihje shpirtin përpara se të vishej me trup.

Piktura, me gjithë përkryerjen e saj, m’u duk si përmbytje. Nuk po e shihja si “heqje mënjanë”, përkundrazi. Vizatimi në krah m’u shfaq si një thirrje e fshehtë, një pështpërimë që vinte nga thellësia. E pamjaftuar, e papërfunduar, por e pakrahasueshme në frymë. Isha thjesht i paralizuar nga fuqia e tij, zhveshur nga çdo iluzion, çdo shkëlqim e çdo shtesë. Ndoshta ky vizatim edhe në kohën kur u krijua ndryshoi syrin e shikuesit, mentalitetin e tij, që të mos shihej më si shërbëtor servil i pikturës. Aty, atë çast, piktura m’u duk si gjuha e trupit dhe vizatimi si gjuha e shpirtit. Në fund të fundit, vetë Leonardo shkruante se: “Vizatimi është rruga më e sinqertë për të lexuar mendjen e dikujt.”

Gjithçka nis me një vizë. Jo vetëm te vepra, por edhe te vetë njeriu. Që në fëmijëri, vizatimi shfaqet si një mjet i parë i të shprehurit. Fëmijët shkarravisin e vizatojnë duke projektuar botën e tyre të brendshme përmes figurave të thjeshta, por shpesh domethënëse. Kjo nuk është rastësi. Vizatimi është një akt i pastër, i çliruar nga gjykimi, një mënyrë për të komunikuar me ndjenjat përtej filtrit të arsyes. Si fëmijë, mësova të vizatoja para

se të flisja. Para se të shkruaja, bëja vija, rrathë, spirale, derisa fokusova objektet. Ato vizatime i nxirrja jashtë pa filtra, pa dekor, pa bukuri të sforcuar. Ishin germat e para të të shprehurit.

Artisti vetë, kur vizaton, duket si anatomist i së padukshmes. Vijat që ai i lë si gjurmë në letër, janë gjurmë jete, janë rrahjet e pulsit të tij, si edhe piktura. I tillë, vizatimi nuk është vetëm akt përgatitor. Është magji më vete. Është gjuha e asaj që ende nuk ka ndodhur. Nuk i bindet ngjyrës, nuk i shërben dekorit.

I shërben thelbit.

Më ndodh shpesh të mendoj se piktura i ngjan jetës së jashtme, ndërsa vizatimi jetës së brendshme. Piktura të kërkon të jesh i plotë, vizatimi të lejon të jesh i thyer. Aty ku ngjyra flet për dritën, vija flet për hijen, që ngrihet nga mendja. Në skajet e një vizatimi, lëviz dora e Arkitektit të

Madh, ku në qendër është njeriu lakuriq dhe i pambaruar, i sinqertë dhe i çuditshëm. Me këtë gjuhë, ne mund të bërtasim pa zë, të tregojmë dashuri pa objekt, të rrëfejmë ëndrra pa ngjyrë. Shpellë e vërtetë nuk është sfondi i errët i pikturës, por është vizatimi, aty ku banon e pathëna, e padukshmja, ajo që nuk është ngjizur ende, por ndihet si prani.

Piktura të josh fort, vizatimi të fton brenda. Piktura të kënaq syrin, vizatimi të ndriçon shpirtin. Piktura është rezultat, vizatimi është udhëtim dhe ndoshta për këtë arsye përpara asaj pikture të mrekullueshme, të përkryer, ndjeva një boshllëk, ndërsa përballë vizatimit ndjeva esencën e boshllëkut.

Në një botë ku fjala është bërë e lehtë, e shpejtë dhe shpesh boshe, vizatimi mbetet një nga mënyrat më të thella e më të ndershme të komunikimit. Ai është më shumë sesa një art, është një magji e brendshme, që merr jetë përmes

dorës së njeriut dhe shtrihet në letër si një frymë që nuk mund të ndalet. Magjia e tij qëndron në faktin se nuk ka nevojë për përkthim. Një vizatim, si edhe piktura, kuptohet njësoj si nga një fëmijë ashtu edhe nga një i moshuar dhe aty ku nuk arrijnë dot fjalët, fillojnë vijat.

Magjia e vërtetë e vizatimit është se ai nuk kopjon realitetin, por e rikrijon atë në mënyrën më intime dhe personale. Objekti nuk është më objekt, por mënyra si ndihet thelbi i tij, pa të tepërta. Kjo e bën vizatimin një akt të thellë emocional, por edhe filozofik. Vizatimi, gjithashtu, është një mjet i fuqishëm për të përballuar veten. Në kohë trazimi, ankthi apo dhembjeje, të shumtë janë ata që zgjedhin të vizatojnë, qoftë edhe në tryezën e një kafeneje çfarëdo. Nuk pikturojnë, por vizatojnë. Jo për të treguar diçka të bukur, por për të çliruar atë që i rëndon brenda. Ai bëhet një lloj terapisti i heshtur, një pasqyrë që të ndihmon të shohësh më qartë vetveten. Në kaosin e vijave të hedhura

kuturu fshihet vetë shkarravitësi që po vizaton. Është art-terapi. Është dëshmia se brenda njeriut fshihet diçka më shumë sesa logjika, një burim ndjenje, ëndrre dhe krijimtarie. Përmes tij, arrijmë të prekim të padukshmen, të shprehim të pathënën, të kuptojmë veten dhe botën. Dhe në një kohë kur gjithçka matet me shpejtësi dhe produktivitet, vizatimi na mëson të ndalemi, të shikojmë më thellë dhe të dëgjojmë atë që nuk flitet.

Për këtë arsye, ndoshta, vepra më e madhe e Da Vinci-t nuk është Mona Lisa.

RIKTHIMI

Këto vërtisja në mendje atë ditë në Louvre, përballë Leonardo-s. Ishte thjesht ndjesi. I shkruaj këto radhë, sepse po ribëj veten nëpërmjet vizatimit. Nuk është një proces i thjeshtë krijimi, por një udhëtim i brendshëm, një kthim në vendet e braktisura të kujtesës, ku gjërat e pathëna kanë mbetur pezull në ajër për shumë kohë. Në çdo vijë,

në çdo nuancë që vizatoj, ndiej sikur po i jap formë një pjese të vetes, që më parë nuk kam ditur ta emërtoj. Shumë nga imazhet e mia përsëriten si refren. Janë figura, forma, dritëhije, sfumatura, që vijnë sërish dhe sërish, si për të më thënë diçka që nuk arrita ta dëgjoj herën e parë. E kuptoj se këto nuk janë përsëritje rastësore. Janë kujtime të mbjella dikur, ndoshta pa vetëdije, si fara të hedhura në një kohë të largët, që tani kanë filluar të mbijnë. Kthehem tek ato imazhe jo për t'i kopjuar, por për t'i rifilluar, për t'i rishikuar me sytë që kam sot, sy të ngarkuar me kohë, përvojë dhe ndoshta edhe plagë.

Pse ndodh kjo? Pse më shtyn vetja të kthehem pas?

Nuk është thjesht nostalgji. Është diçka më e thellë, një lloj arkeologjie e brendshme, ku bëhem kërkues i heshtur në tokën e vetvetes. Gërmoj në shtresat ku kam varrosur pjesë të pavetëdijshme të qenies sime, pjesë që atëherë nuk kisha as

fuqinë dhe as dritën për t'i parë. Tani, me kohën që kam kaluar dhe me veten që kam ndryshuar, u rikthehem dhe ajo që zbuloj nuk është e njëjta gjë. Ishte kur ishte, s'është më. Edhe kur duket e njohur, flet ndryshe.

Në këtë mënyrë, përsëritja në art nuk është kthim mbrapa. Është riformësim, rikonfigurim. Si një dialog që fillon atje ku kishte mbetur pezull, por me fjalë të reja. Është si një përpjekje për të kuptuar më mirë rrënjët që më kanë formësuar. Të ribësh një imazh është si të ribësh një pjesë të vetes, një akt i kujdesur dhe i ndershëm për ta kuptuar më thellë të kaluarën. Kjo lloj pune me veten nuk është as e lehtë, as e shpejtë, por është e domosdoshme. Mbase kjo është mënyra më e sinqertë për të mos e humbur unin tënd kur rikthen në duar ato copëza që të kanë ndërtuar, t'i shohësh me sy të rinj dhe t'u japësh një jetë tjetër. Në këtë mënyrë, përpara se të ecësh përpara,

pranon se rruga drejt vetes kalon përherë nga e kaluara.

Mbjellim nga e njëjta farë.

Galeria FAP, 17 Tetor 2025